



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM
Nr. 35, datë 07.10.2024**

**PËR
MIRATIMIN E PËRQINDJES SË PAGESËS RREGULLATORE VJETORE**

Në mbështetje të nenit 2, 10 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar dhe nenit 9 të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjetllës-Kanalizime”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore vjetore në masën 0.77% për të gjitha shoqëritë ujësjetllës kanalizime.
2. Për shoqëritë UK që aplikojnë për nivel të ri tarifor, ky koeficient do të aplikohet mbi të ardhurat vjetore të parashikuara nga aktiviteti i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.
3. Për shoqëritë UK që nuk do të aplikojnë për nivel të ri tarifor, ky koeficient do të aplikohet mbi të ardhurat e realizuara të vitit paraardhës.
4. Ngarkohen strukturat e ERRU-së dhe të gjitha shoqëritë UK për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 38, datë 05.10.2023, “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARE
Evis Shurdha**